



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim

Mbledhja nr. 37

Prishtinë, 5.04.2019. në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Ne mbledhje morën pjesë: Igor Simiq, kryetar, Xhelal Sveçla- nënkryetari i parë, Danush Ademi - nënkryetar i dytë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Rasim Selmanaj, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević, Albert Kinolli, Slobodan Petrović dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Mufera Serbica Shinik, Duda Balje dhe Haxhi Shala, anëtarë;

Pjesëmarrës të tjerë: Përfaqësues i Komitetit Këshillëdhënës për Komunitete në Kabinetin e Presidentit të Republikës, vëzhgues I mediave të KD –a, RTK 2, Kosova Pres, Zijush Ahmeti KSZ dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Personeli për mbështetjen e komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu;

Mbledhjen e kryesoi : **Igor Simiq**, kryetar i komisionit

Në mbledhje u propozua ky:

R e n d i d i t ë s :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportimi i Ministrisë të Punëve të Brendshme z. Ekrem Mustafa, me temën: **Regrutimi i përfaqësuesve të komunitetit joshumicë, në bazë të konkursit të fundit të policisë së Kosovës;**
3. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me datë 26.2.2019, 7.3.2019 dhe 28.3.2019;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Kryetari, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime.

Kryetari, Igor Simiq, e hapi mbledhjen e sotme për raportim para komisionit, me qëllim të marrjes së informacioneve të nevojshme dhe të dhënave zyrtare. Pastaj i përshëndeti përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, në krye me z. Ekrem Mustafa, përfaqësuesit e Policisë së Kosovës në krye me Drejtorin i Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, z. Rashit Qalaj, përfaqësues i KDI, ICITAP, si dhe përfaqësuesit e Zyrës për Komunitete në Zyrën e Presidentit të Kosovës.

Njëkohësisht i ftoi anëtarët e Komisionit për pjesëmarrje në punëtorinë në formë të pyetjeve dhe sugjerimeve

Ministri, z. Ekrem Mustafa

Drejtori i Policisë së Kosovës, z. Rashit Qalaj

Ne fjalën e tij para komisionit, theksoi se Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, vazhdimisht analizon nevojat e saj dhe ne përputhje me këtë i shpall konkurset. Policia e Kosovës synon të edukojë zyrtarët policor të cilët janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë në mënyrë të drejtë, të komunikojnë qartë, të marrin vendime, të udhëheqin dhe të përballojnë me sukses sfidat e ardhshme. Nëse një kandidat nuk kalon një nga fazat e testimit ai / ajo nuk ka të drejtë të vazhdojë me faza të tjera dhe nuk ka të drejtë të përsërisë testin. Në çdo rast, kandidati ka mundësi përsëri të aplikojë për këtë pozitë në konkurset e shpallura në të ardhmen. Në përgjithësi jemi të kënaqur me numrin e atyre që konkurruan e posaçërisht me numrin e pjesëmarrësve të komuniteteve jo-shumicë që jetojnë dhe punojnë në Kosovë. Megjithatë, ministria nuk është e kënaqur me numrin e atyre që kanë kaluar minimumin prej 70% të suksesit të kandidatëve të komunitetit pakicë dhe se në të ardhmen duhet të shihet se çfarë duhet bërë për të qenë më të suksesshëm në këto konkurse, që të jenë më të përfaqësuar në përbërjen e Policisë së Kosovës. Në lidhje me shpalljen e konkursit nga Policia e Kosovës dhe përfaqësimit të komuniteteve, drejtori i Policisë së Kosovës, z. Qalaj, tha se konkursi ishte i hapur nga data 16.04.2018 deri më 10.05.2018 dhe se aplikuan më shumë se 17.000 kandidatë. Prej 15,000 kandidatëve të cilët kanë aplikuar janë meshkuj, dhe më shumë se 2,000 kandidatë janë femra. Në krahasim me vitet e kaluara, për pranimin e policëve të rinj, pjesëmarrja e komuniteteve jo shumicë të cilët jetojnë dhe punojnë në territorin e Republikës së Kosovës, është në nivel të kënaqshëm. Të gjithë këta kandidatë në fazën e parë të testit me shkrim, duhej të kalonin një minimum prej 70% të pikëve, për t'u kualifikuar për testin me gojë, testin fizik dhe psikologjik dhe natyrisht të kalonin testin e përkatësisë së kandidatit. Prej gjithsej 17,000 kandidatëve që kanë aplikuar, 2,297 kandidatë kanë kaluar të gjitha llojet e testeve, e prej tyre 30% janë femra si dhe aktualisht 3,19 kadetë janë duke u trajnuar në Akademinë e Policisë në Vushtrri, prej të cilëve 25 serbë, 1 turk, 1 ashkali, 1 egjiptian dhe 1 goran.

Në vazhdim të mbledhjes, anëtari i komisionit, **Danush Ademi**, pyeti në lidhje me procedurat dhe kriteret e procesit të rekrutimit të kandidatëve. Nga të gjithë 64 kandidatët e komunitetit ashkali, është e çuditshme dhe shqetësuese që asnjë kandidat nuk i ka përmbushur kriteret për testin psikologjik dhe të përgatitjes fizike ! Duhet të ndërmerret diçka në lidhje me këtë çështje, si p.sh. të organizohen trajnime, të bëhet hartimi i programeve dhe parashikimi i disa masave afirmative

për të korrigjuar këtë situatë. Në shumë institucione, përfaqësimi i komunitetit ashkali është më i ulët se pjesëmarrja e tyre proporcionale në popullatë, sikurse edhe në Policinë e Kosovës.

Veton Berisha, theksoi se sipas Kushtetutës, organizimi i brendshëm i Policisë së Kosovës është e rregulluar me ligj dhe se përbërja etnike e policisë duhet të pasqyrojë strukturën etnike të popullsisë. Kuota ligjore është 10% e përfaqësimit të kandidatëve që kanë aplikuar për shërbim në polici, duhet të respektohet dhe të gjendet një mekanizëm për zbatim. Shteti është i detyruar që të ndërmerret masat e duhura për barazinë e plotë të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat, për të realizuar të drejtën për përfaqësim të barabartë gjatë punësimit në organet publike, e veçanërisht në shërbimin policor, në pjesën e banuar nga komuniteti përkatës, duke respektuar rregullat në aspektin e aftësive pa diskriminim. Ky konkurs ka treguar se nuk ka qenë real gjatë punësimit të pjesëtarëve të komunitetit egjiptian. Kjo situatë paraqet shkelje të legjislacionit përkatës në fuqi. Duhet bërë gjithçka, për të gjetur një zgjidhje të drejtë dhe të barabartë për të gjitha komunitetet, pa favorizime. Kjo situatë është shqetësuese dhe duhet të ndryshojë. Ky është një problem ligjor ku duhet të ndërhyri.

Igor Simiq, i paraqiti të dhënat zyrtare dhe shqetësuese të Raportit të Organizatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, i cili thotë se nga gjithsejtë 100 sulmeve pronësore, vetëm 5 raste janë zgjidhur. Për shkak të tendencës së rritjes së krimeve të tilla, ai kërkoi një përgjigje, nëse ministria ka një plan për parandalimin e krimeve kundër pasurisë serbe, trashëgimisë kulturore dhe fetare të Kishës Ortodokse Serbe dhe dëmtimit të varrezave.

Xhelal Sveçla, theksoi se raportimi i sotëm i ministrit dhe bashkëpunëtorëve të tij, rregullon çështjen e rëndësishme të rekrutimit të përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë, në konkursin e fundit të Policisë së Kosovës. Mendoj se nuk është e drejtë që debati të zhvillohet për çështje të tjera dhe se kjo tryezë të abuzohet dhe përpiqet të devijoj temën e trajtuar nga komisioni. Sulmet ndaj komunitetit serb nuk janë sulme të natyrës etnike, por janë konfliktet e brendshme të këtij komuniteti. Interesi im është përqendruar në marrjen e një shpjegimi nëse përbërja etnike e Kosovës mbulon të gjitha aktivitetet duke marrë parasysh diversitetin e shoqërisë sonë, si dhe nëse ka vështirësi në polici për shkak të mungesës së policëve nga një komunitet i caktuar. A ekziston një kuotë ligjore për përkatësinë etnike dhe a ka ndonjë nismë për fillimin e një fushate për rekrutim dhe fushate për ngritjen e kapaciteteve?

Për arsye të mungesës së kuorumit, **Xhelal Sveçla**, konstatoi se pika tretë e rendit të ditës do të shqyrtohen në mbledhjen e radhës,

Mbledhja përfundoi në orën 14:10

Përgatitur nga; Njësia mbështetëse e Komisionit

**Kryetar i Komisionit ,
Igor Simiq**

PROCESI I REKRUTIMIT NË POLICINË E KOSOVËS

Shtojca tabelore

Tabela nr. 1. Raporti etnik i pjesëtarëve të PK-së krahasuar me numrin e popullsisë sipas regjistrimit 2011

Etniteti	Pjesëmarrja Etnike në Popullsi %	Pjesëmarrja Etnike në Polici të Kosovës %	Aplikues në PK (Konkursi_2018)	Pjesëmarrja Etnike e Aplikuesve %
Shqiptar	92.93%	83.65%	16263	92.30%
Serb	1.47%	11.95%	865	4.91%
Turk	1.08%	0.87%	101	0.57%
Boshnjak	1.58%	2.40%	196	1.11%
Rom	0.51%	0.19%	34	0.19%
Ashkali	0.89%	0.22%	64	0.36%
Egjiptian	0.66%	0.09%	58	0.33%
Goran	0.59%	0.45%	27	0.15%
Të tjerë	0.14%	0.17%	12	0.07%
Totali	100.00%	100.00%	17620	100.00%

Të tjerët (Aplikim)_Konkurs_2018	
Çerkez	1
Kroat	3
Malazez	7
Maqedon	1
Totali	12

Gjinia	Nr
Mashkull	15262
Femër	2358
TOTALI:	17620

Tabela nr. 2 Përfaqësimi etnik në gjeneratën aktuale

Gjenerata_54 e përfshirë në DEP. Burime Njerëzore						
Shqiptar	Serb	Turk	Boshnjak	Egjiptian	Goran	Total
389	26	1	1	1	1	419

Tabela nr.3 Të dhënat nga lista e pritjes sipas konkursit të shpallur për zyrtar policorë 2018 sipas etnitetit dhe gjinisë.

Etniteti	F	M	Total	%
Ashkali		4	4	0.22%
Boshnjak		22	22	1.23%
Çerkez		1	1	0.06%
Egjiptian		1	1	0.06%
Goran		1	1	0.06%
Malazez		1	1	0.06%
Serb	12	78	90	5.03%
Shqiptar	82	1581	1663	92.91%
Turk		7	7	0.39%
Total	94	1696	1790	100.00%

Gjinia	Total	%
F	94	5.25%
M	1696	94.75%
Total	1790	100.00%

Tabela nr.4 Statistika e kandidatëve që kane kaluar testet sipas gjinisë dhe entitetit Konkursi për zyrtar policor 2018

e a	te kualifikuar		Test me shkrim		Test fizik		Interviste		Lista Meritore		Gjenerata 54										
	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	Gjen 54		Psikologjik		Mjekësor e		DSP		Nënshkr imi kontratë s		
0	4	57		5		4		4		4											
7	27	158	3	36		25		24		24		2		2		1		1			1
		1		1		1		1		1						1					
2	6	51	2	5		2		2		2		1		1		2		1			1
5	1	23		8		3		3		3		2		2				1			1
		2																			
	1	5		1		1		1		1											
		1		1																	
9	5	27																			
3	185	628	39	158	21	100	21	100	21	100	9	22	9	22	9	18	9	17	9	17	
1 5	201 0	13420	40 8	3171	22 5	197 1	22 4	190 9	22 4	190 9	142	32 8	140	325	12 6	294	12 3	27 7	12 2	27 5	
1	19	74	1	8	1	7	1	7	1	7	1		1		1		1		1		
2 4	225 8	14447	45 3	3394	24 7	211 4	24 6	205 1	24 6	205 1	152	35 5	150	352	13 6	316	13 3	29 7	13 2	29 5	
0	16705		3847		2361		2297		2297		507		502		452		430		427		